

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO TASE

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë të përzgjedhur nga populli dhe nga vjedhjet e fundit,

Dal sot para jush, por jo vetëm, dal edhe para një populli, i cili për tetë vjet me radhë po vuan çdo ditë nga një qeveri, të cilës tashmë, e ngopur prej vjedhjeve kolosale, i ka mbetur për t'jua marrë vetëm dinjiteti. Gjatë fushatës zgjedhore kam pasur mundësinë të prek nga afër zona, të cilat kishin vite që nuk vizitoheshin nga pushtetarët. Jam gjendur përballë një situatë tejet dramatike. Shumë pranë qytetit të Fierit ndodhen zona që kanë një realitet tjetër nga ai që shfaqet në ERTV, një realitet i hidhur, por që është fytyra e vërtetë e këtij pushteti.

Ndjeva trishtim në sytë e tyre, trishtim për mungesën e bukës së gojës. A keni shkelur ndonjëherë në Sopë, Strumë, Shtyllas apo në Hoxharë të Re? Me siguri as nuk e keni idenë se ku ndodhen. Ndofta ju duket qesharake që aty ende jetojnë njerëz, të cilët e punojnë tokën e tyre me forcën e krahut, sepse nuk i përballojnë dot kostot e naftës për automjete. Me siguri ju duket qesharake edhe përjetimi im si kandidat e zonës, që jo pak herë jam përplotur duke u përballur me një realitet aq të vrazhdë. Ata luftojnë çdo ditë për të pasur të mira bazike për mbijetesë. Po e quaj mbijetesë, sepse të vuash për ujin e pijshëm dhe bukën e gojës as nuk mund të konsiderohet jetesë. Kam vizituar 74 fshatra të qarkut të Fierit dhe tri qytete. Ata nuk kërkojnë makinat e fundit dhe as ato më të shtrenjtat, ata nuk kërkojnë që të marrin të ardhura pa punuar; ata kërkojnë të ushqejnë fëmijët e tyre me dinjitet. A e dini çfarë do të thotë dinjitet? Nuk pres që shumë nga ata që kanë ardhur këtu me vota të vjedhura të kuptojnë se çfarë do të thotë të kesh dinjitet. Nuk ka si ta dinë, kur vetë ata çdo ditë vjedhin të ardhmen e fëmijëve tanë dhe të brezave që do të vijnë pas tyre.

Edhe sa duhet të paguajnë shqiptarët për tekat dhe iluzionet e një Kryeministri, i cili nuk ka respekt as për gratë e partisë së tij? Ju, të nderuara gra socialiste, e dini shumë mirë këtë fakt; e dini shumë mirë, edhe pse nuk e artikulonin, që kjo qeveri është një one man show. Kemi më shumë se një vit që luajmë hapadollapa me virusin COVID-19, që përjetojmë fasha orare të vendosura pa asnjë logjikë shkencore. Bëmë tre muaj karantinë absolute, me qëllim që qeveria të përgatiste strukturat spitalore. Tre muaj kohë për tenderë për maska të skaduara dhe tre muaj rrënim ekonomik, i cili sa vjen dhe thellohet. Qytetarët tanë po vuajnë për bukën e gojës, ndoshta ju duket e çuditshme. Qytetarët tanë po largohen nga ky vend, sepse nuk i besojnë historitë me lakror Korçe, "që paguhet 4 mijë euro"; nuk i besojnë më historitë e sukseseve të mëdha të kësaj qeverie. Çfarë keni ndër mend të bëni për këtë fakt apo do të nxirrni skandale të tjera për të mbuluar ato që ndodhin çdo ditë? Sa beketë duhet të presim?! Kjo është një qeveri, që drejtohet nga një Kryeministër që ka përdhosur çdo të drejtë njerëzore, ka përdhosur fjalën e lirë, ka përdhosur profesionin e gazetarit, dhe ata që nuk kanë mundur t'i përdhosë i ka hequr nga puna, duke u mohuar bukën e gojës. Kjo është një qeveri që në programin e saj ka përmendur vetëm 4 pika në lidhje me artin dhe kulturën. 4 pika ka arti dhe kultura jonë në këtë program, por që nuk i paraqesin fare nevojat reale të artit shqiptar. Zhvlerësimi i artit u tregua me shembjen tinëzare të Teatrit Kombëtar në mes të karantinës absolute, natën, në pabesi të plotë. Edhe Gjykata Kushtetuese po e mbron çështjen e teatrit, sepse pasuria shqiptare dhe kolektive meriton të mbrohet. Por kjo nuk i hyn në sy një qeverie që përdor automatikë të mbushur kundër artistëve, të cilët janë të armatosur deri në dhëmbë vetëm me drejtësi. Por mbase kërkoj shumë kur flas për artin,

kulturën dhe fjalën e lirë. Të duket luks, në fakt. Meqë arti nuk paska rëndësi për ju, atëherë po ju them se para pak ditësh një vajzë e re u vra në mënyrë makabër dhe kjo qeveri as nuk ka denjuar të reagojë. Apo këto ndodhin veç në filma? A keni kërkuar falje për këtë jetë të humbur? Po për jetët e mëparshme, që kanë humbur si pasojë e politikave të dobëta dhe të pavlera, të cilat as me letër nuk duken më të bukura? Edhe sa vdekje duhet të ndodhin që qeveria të kuptojë se ministritë nuk janë pasarela mode, por janë vende të cilat duhet të prodhojnë politika dhe vlera njerëzore? Sabrina, Menturia, Klarita, Diana, Zhaneta, Kristina, Liljana, Dorina. Fëllënxa, Irvana, Luljeta, Sanija, Anisa dhe Joana janë 14 gra shqiptare të vrara nga partnerët vetëm për këtë vit. Por, a i kanë vrarë vetëm ata, apo i ka vrarë edhe kjo qeveri me këto palo politika që bën?! Vrasjet, aksidentet automobilistike, krimi dhe politika e shëmtuar, janë të vetmet gjëra që dëgjojmë sapo zgjohemi në mëngjes. Të gjitha këto probleme kanë të njëjtin burim, por, nëse nuk ndryshon vullneti politik, regresi që ka nisur prej 8 vjetësh do të na degradojë në një shtet pa gra, pa mjekë, pa mësues, pa artistë, pa të rinj, pa fermerë, dhe, për fat të keq, pa shqiptarë.